

# ECU SACCO

Per una raccolta del SECCO più ECO e più EQUA

## PÉRSE E BÈN

ÈSHTË një projekt eksperimental që lind me objektivin që të pakësoje sasinë e mbeturinave të “thata” dhe të vendosi një taksë më të barabartë/drejtë, për të bërë këtë qytetari duhet të jetë më shumë i vetëdijshëm dhe pjesëmarës.

Eksperimenti ka të bëjë me mbledhjen e materialit të THATË: përveç furnizimit të parë me qese EKOLOGJIKE, (e përshtatshme për nevojat familjare dhe mbi të cilën llogaritet taksa “TARI”), përdoruesi paguan nëse përdor më shumë qese nga ato që ka marrë. Projekti po përfshim një numër gjithmonë dhe më të madh të Komunave “CEM Ambiente” me rezultate ekologjike të vlerësueshme.

**Bëhesh** një qytetar më shumë i virtytshëm dhe i vetëdijshëm

**Paguan** në bazë të sasisë të mbeturinës “të thatë” që prodhon.

**Më pak mbeturinë të Thatë** prodhon dhe më shumë mbron ambientin dhe vendin ku jeton.

**Përmirëson** përqindjen e mbledhjeve të diferencuara të Komunës tënde  
**Rrit risurset** ekonomike për komunitetin tënd, falë kursimit të aritur duke diferencuar më shumë.

## KËSHILLAT PËR NJË PRAKTIKË TË MIRË

**Zvogëlo** sa më shumë që të mundesh volumin e mbeturinave të tua në mënyrë që të mbushësh mirë qesen ekologjike.

**Bëj shpenzimet duke menduar** se sa mbeturina do të prodhosh

**Respekto** territorin në të cilin jeton. Mos flak mbeturinat në koshte publikë, në buzë të rrugës ose në vendet e gjelbëruara.

**Mendo** gjithmonë për atë që po flak: verifiko nëse mund t’a hedhësh në një nga mbledhjet e diferencuara.



Per informazioni e segnalazioni

**800.342.266**

info e segnalazioni online:  
[www.cemambiente.it](http://www.cemambiente.it)

# ECU SACCO

## Per una raccolta del SECCO più ECO e più EQUA

### SI KU DHE KUR

#### Çfarë është qesja EKologjike?

Qesja EKologjike është qesja e re **gjysëmtraspjendte** dhe e **gjurmueshme** për t'u përdorur **detyrimisht** për mbledhjen e mbeturinave të thata

#### Çfarë duhet të vendos në qesen EKologjike?

Mbeturinat "e thata" ( Listën e gjen mbrapa kalendarit "CEM AMBIENTE" të Komunës tënde). Kujtohu të vendosësh në qesen EKologjike mbeturinat e lira pa i mbyllur në qese të tjera

#### Ku shpërndahet qesja EKologjike?

Në pikat e shpërndarjes në ditët dhe oraret e treguara mbrapa kalendarit "CEM AMBIENTE" në Komunën tënde.

Tërheqia qeseve EKologjike është e domosdoshme

#### Për sa qese EKologjike kam të drejtë?

Numri i qeseve që të takon varet nga përbërja e familjes tënde

#### ÇFARË më duhet për të tërhequr qesen EKologjike?

Për tërheqien e qeseve duhet të shkosh në pikat të shpërndarjes me kartën tënde "CRS" Karta Rajonale e Shërbimeve ose "CNS" Karta Shtetërore e shërbimeve ose "CEMcard"

#### Nëse më duhen qese të tjera EKologjike, ku mund t'i ble dhe sa kushtojnë?

Mund t'i blesh tek Zyra Ekologjike e Komunës tënde, duke përdorur taserën "CRS" ose "CNS" ose "CEMcard" tënde me koston prej:

- 10 € për një rotull me 15 qese EKologjike prej 40 litrash
- 30 € për një rotull me 15 qese EKologjike prej 120 litrash

Çmimi përfshin koston e flakjes së mbeturinës që përmban qesja.

Pagesa e qese-ve do të ndodhë sipas mënyrave të vendosura nga Komuna jote.

Raste të veçanta:

Familje me fëmijë që nuk kanë mbushur 3 vjeç: në furnizim është i parashikuar një integrim i mëtejshëm i qeseve.

Persona me probleme të mospërmbajtjes: drejtohuni në Komunë për Tërheqien e qeseve me një vetëdeklarim.

#### Mund të përdor qese të tjera për mbeturinat e thata?

Jo, do të tërhiqen vetëm qeset EKologjike.

#### Si mund të përdor qeset gri/të tejdukshme të tepruara?

Mund të përdoren për të hedhur "Multipak".

#### Përse mbi qesen EKologjike është i stampuar një kod?

Sepse në rast nevojë, është e mundur të arrihet tek pronari i asaj EKOqese-je.

#### Përse disa qese EKologjike janë të kuqe dhe të tjera blu?

Qeset EKologjike të **KUQE** janë për përdoruesit shtëpiakë

Qeset EKologjike **BLU** janë për përdoruesit joshtëpiakë (ndërmarrje, dyqane, restorante, kafene etj.)

#### Dyshime të tjera?

Telefono në numrin jeshil të "CEM Ambiente" **800.342.266**



Per informazioni e segnalazioni

**800.342.266**

info e segnalazioni online:

[www.cemambiente.it](http://www.cemambiente.it)